

**STATUT**  
**I**  
**SHOQERISE SE BASHKEPUNIMIT BUJQESOR**  
**"SAZE SHBB"**



**KREU I**

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

**Neni 1 - Krijimi**

DATA E THEMELIT, EMRI DHE THEMELUESIT

Themeluesit e Shoqërisë së Bashkepunimit Bujqesor, emrat e të cilëve shënohen në fund të këtij Statuti, në bazë të Ligjit Nr. 38/2012, datë 05 Prill 2012 "Për Shoqëritë e Bashkepunimit Bujqesor", themelojnë Shoqërinë e Bashkepunimit Bujqesor "SAZE SHBB" e cila më poshtë për lehtësi, do të quhet "Shoqëria".

**Neni 2 – Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është: **SAZE SHBB**

**Neni 3 - Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqërisë do të jete deri me 31/12/2050.

**Neni 4 - Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë është në adresën: Gjirokastër, Përmet, Fshati "Petran", Pasuria numer 56/50, Zonë Kadastrale 1946.

Ajo mund të transferohet në çdo vend tjetër të zonës së saj territoriale me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 5 - Objekti**

Shoqëria ka si objekt:

Realizimi i veprimtarive të përbashkëta ekonomike nga antaret e saj, në fushën e prodhimit bujqësor dhe marketingut, në veprimtarinë e punës bujqësore, për imputet dhe për qellime të tjera në fushën e bujqësisë.

**Fusha e Veprimtarisë së "SAZE SHBB" është:**

- Kultivimi dhe prodhimi i fruta-perimeve për tharje.
- Seleksionimi, ambalazhimi dhe tregtimi i fruta-perimeve të thara.
- Të shtohet çfarë do bëhet tjetër...
- Blerja, marrja me qira, manaxhimi i shërbimeve agro-mekanike, dhënia me qira ose qira kolektive e makinerive të nevojshme për aktivitetet e ortakeve apo të treta.
- Blerja ose marrja me qira e impjanteve për përpunimin, konservimin dhe transformimin e

*(Handwritten signatures and initials in blue ink)*



produkteve bujqesore per llogari te vete, te ortakeve apo te treteve

- Blerja ose shitja kolektive e produkteve bujqesore te nevojshme per bujqesine, dhe per gjithcka tjeter te nevojshme per zhvillimin e bujqesise dhe nevojave te ortakeve dhe te treteve.
- Blerja, dhenia me qira, shitja, ndertimi apo marrja me qira te pasurive te paluajtshme ne funksion te selise qendrore, magazinave, oficinave, rishitje e mjeteve teknike, mekanike, import-eksport, pajisje ne pergjithesi.
- Realizimi dhe menaxhimi i zonave te gjelbra publike dhe private.
- Dhenia e sherbimeve te projekteve ne pergjithesi, konsulenca teknike, trajnime dhe cdo gje te nevojshme per zhvillimin e territorit me pjesmarres shoqerine dhe/ose partnere te jashtem.
- Shoqeria mund te kryeje te gjitha aktet dhe negociatat juridike te nevojshme per realizimin e qellimeve te saj.
- Shoqeria mund te kete interesa dhe pjesmarrje ne ndermarrje te tjera nen cdo lloj forme kushtetuese, konsorciume, shoqata me qellim investimin e qendrueshem dhe jo futjen ne treg, me kusht qe te mos ndryshoje ne mas te madhe objektin e percaktuar nga statuti.

## KREU II


### KAPITALI I REGJISTRUAR

#### Neni 6 - Kapitali Social, vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

Kapitali Social i shoqerise eshte 100.000 leke, (njqindmije).

Kapitali eshte teresisht kontribut i themeluesit te shoqerise, ortakeve si me poshte :

1. **Anila Murataj** lindur me 08.04.1979, ne Tirane dhe banuese ne Tirane, identifikuar nepermjet leternjoftimit ID nr 036013168, nr. Personal H95408053W, leshuar ne date: 05.05.2020. Nje kuote me vlere 14.000 lek qe korrispondon me 14 % te vleres se kapitalit.
2. **Asim Sula** lindur me 17.04.1968, ne Luzaj dhe banues ne Elbasan, identifikuar nepermjet leternjoftimit ID nr BR5233122, nr. Personal G80417196V, leshuar ne date: 21.02.2020. Nje kuote me vlere 14.000 lek qe korrispondon me 14 % te vleres se kapitalit.
3. **Nertan Prifti** lindur me 14.09.1982, ne Librazhd dhe banues ne Tirane, identifikuar nepermjet leternjoftimit ID nr 036535163, nr. Personal I20914060L, leshuar ne date: 19.10.2020. Nje kuote me vlere 16.000 lek qe korrispondon me 16 % te vleres se kapitalit.
4. **Arber Xhaferaj**, lindur me 27.10.1985, ne Tirane dhe banues ne Tirane, identifikuar nepermjet leternjoftimit ID nr 036201221, nr. Personal I51027051J, leshuar ne date: 13.07.2020. Nje kuote me vlere 14.000 lek qe korrispondon me 14 % te vleres se kapitalit.
5. **Armanda Saku** lindur me 17.07.1983, ne Tirane dhe banuese ne Tirane, identifikuar nepermjet leternjoftimit ID nr 036535431, nr. Personal I35717065C, leshuar ne date: 19.10.2020. Nje kuote me vlere 14.000 lek qe korrispondon me 14 % te vleres se kapitalit.
6. **Doloreza Prifti** lindur me 18.01.1981, ne Leskovik dhe banuese ne Tirane, identifikuar nepermjet leternjoftimit ID nr 034235852, nr. Personal I15118053K, leshuar ne date: 17.05.2019. Nje kuote me vlere 14.000 lek qe korrispondon me 14 % te vleres se kapitalit.
7. **Renis Prifti** lindur me 13.05.1979, ne Tirane dhe banues ne Tirane, identifikuar nepermjet leternjoftimit ID nr 033596605, nr. Personal H90513055K, leshuar ne date: 20.02.2018. Nje kuote me vlere 14.000 lek qe korrispondon me 14 % te vleres se kapitalit.





Kapitali themeltar do te derdhet prane nje banke te nivelit te dyte, sipas legjislacionit ne fuqi.

Kapitali Social i Shoqërisë përbëhet nga vlera e kontributeve te paguara nga secili prej anëtarëve.

Kapitali Social i Shoqërisë përbëhet nga vlera e kontributeve te anetareve të paguara nga anëtarët themelues dhe është 100.000 (njqindmije) lekë.

#### **Neni 7 - Pagesa dhe terheqja e ortakeve**

-Administrata mund t'i kerkojne ortakeve pagesen e kuotave te pashlyera. Ne kerkesen e pageses specifikohen menytrat dhe periudha e parashikuar; afati perfundimtar i parashikuar i eshte prej 30 ditesh kalendarike. Menytrat mund te parashikojne shlyerjen me keste. Ortaku i cili ka transferuar kuotat vetjake tek te tretet do te jete pergjegjes per shlyerjen e tyre.

-Zoteruesit e perbashket te nje kuote do te jene pergjegjes bashkerisht dhe ne menyre solidare per shlyerjen e kontributeve, sipas modaliteteve te shpjeguara ne piken e mesiperme.

-Ne rast se nuk kryhet pagesa e kuotes brenda afatit te parashikuar, ortaku pervec shlyerjes se kuotes, duhet te paguaje nje interes mbi shumen e papaguar me nje kamatvonesë prej 3 % ne vit , duke filluar nga dita e parashikuar per pagesen deri ne daten e pageses.

-Ne rast se pagesa perkatese nuk kryhet brenda afatit te parashikuar, Administratoret mund te njoftojne paraprakisht te pakten 7 dite kalendarike personin pergjegjes per shlyerjen e kontributeve, duke i kerkuar pagesen e shumes se pashlyer se bashku me shumet e mundshme shtese te kamatvoneses. Njoftimi duhet te permbaje paralajmerimin se ne rast mospagese pa arsye mbas disa njoftimeve formale, ortaku do te perjashtohet nga shoqeria.

-Nese pagesat nuk kryhen brenda afatit te njoftimit, Asamblea mund te vendos perjashtimin e ortakut. Anulimi perfshin te gjithë dividendet ose shumet e tjera te pagueshme ne lidhje me ortakun te maturuara deri ne daten e eperjashtimit.

-Ne pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund te shitet, rishperndahet ortakeve ose te kalohet sipas afateve dhe menyrave qe Administratoret konsiderojne te pershtatshme.


-Ortaku i perjashtuar humbet cilesine e ortakut dhe humbet te drejten mbi kuoten sociale, por do te jete pergjegjes ndaj shoqerise per te gjitha kontributet qe do te shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqerise ne daten e anulimit te kuotes se bashku me kamatvonesen e llogaritur per keto kontribute perpara anulimit te kuotes.

### **KREU III**

#### **ORTAKESIMI, TE DREJTAT E DETYRIMET E ORTAKEVE, LARGIMI I ORTAKEVE**

#### **Neni 8 – Procedurat e pranimit**

Ortake te shoqerise jane personat fizike ose juridike, te cilet permbushin nevojat dhe interesat e tyre, qe zhvillojne veprimtari bujqesore ose veprimtari ne mbeshtetje te bujqesise.





Kush deshiron te behet ortak duhet ti prezantoje administratorit kerkesen me shkrim qe duhet te permbaje:

1. Emrin, mbiemrin (emertimin social), kodin fiskal, rezidencen dhe kerkesen e hyrjes si ortak, si edhe vleren e kuotes qe synon te nenshkruaje. Kerkesa vleresohet nga Asemblea e ortakeve ne mbledhjen e ardhshme sipas procedures se percaktuar ne statut.

2. Deklaraten qe do ti permbahet statutit aktual, rregullores qe ai deklarone qe e ka lexuar, dhe vendimeve te adoptuara nga organet e shoqerise.

3. Statuti mund te parashikojte kritere per pranimin e ortakeve te rinj, te cilat lidhen me objektin e shoqerise.

4. Shoqeria mban ne seline e saj nje regjister te ortakeve, i cili eshte publik dhe i konsultueshem dhe qe permban te gjitha te dhenat e tyre identifikuese, adresat, si dhe kapitalin e nenshkruar e te shlyer prej tyre.

5. Cdo ortak i ri dhe cdo veprim, i cili ndryshon kapitalin e nenshkruar apo menyren e ndarjes se tij, si rrjedhoje e pranimin te ortakut te ri, duhet te shenohen ne regjistrin e ortakeve, qe mbahet nga shoqeria, si dhe te regjistrohen ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

#### Neni 9 - Te drejtat e ortakeve

1. Te drejtat dhe pergjegjesite e ortakeve percaktohen ne ligj dhe ne statutin e shoqerise.

2. Ortaket kane keto te drejta dhe pergjegjesi:

- a) te propozojne zevendesimin, emerimin dhe revokimin e administratoreve te shoqerise.
- b) te propozojne ndryshime apo permiresime te statutit.
- c) te ekzaminojne statutin, rregulloren e brendshme ose vendime te organeve drejtuese te shoqerise, kryesisht, kur ka te bejne me interesat e tyre.
- d) te kerkojne dhe te marrin te dhena per gjendjen financiare dhe ekonomike te tyre brenda shoqerise.
- e) te informohen, sa here qe depozitojne kerkese me shkrim, lidhur me gjendjen financiare te shoqerise, kryesisht, per:
  - i) llogarite vjetore financiare;
  - ii) raportin e veprimtarise se shoqerise;
  - iii) menyren dhe procedurat e ndarjes se fitimit;
  - iv) raportet e eksperteve kontabel;
- f) te informohen rregullisht per mbledhjet e asamblese se pergjithshme, duke perfshire informacionin mbi rendit te dites, dokumentacionin e pergatitur per mbledhje, si dhe te dhena te tjera, te cilat lidhen me vendimmarrjen per ceshtje te caktuara, te cilat mund te prekin interesat e tyre.

3. Ortaket kane te drejte te ekzaminojne regjistrin e process verbaleve dhe te vendimeve te Komitetit Ekzekutiv, nese ekziston.

4. Ceshtjet, te cilat kane lidhje me rregullimet statutore, kushtet e regjistrimit apo menyren e drejtimit te shoqerise, si dhe ceshtje te tjera, te cilat trajtohen ne kerkesen e ortakeve qe zoterojne 10 per qind te kapitalit te shoqerise, perfshihen per shqyrtim e diskutim ne rendin e dites se mbledhjes me te pare te asamblese se pergjithshme.

5. Ortaku ka te drejte te kundershtojte refuzimin e dhenies se informacionit, duke iu drejtuar gjykates brenda 30 diteve nga njoftimi per refuzimin.

#### Neni 10 - Kontributet e ortakeve

*(Handwritten signatures and stamps)*



Çdo ortak, derdh në momentin e pranimit për anëtarësim 1 (nje) kontribut anëtarësimi me vlerë 2.000 (dymije) lekë, që i përgjigjet vleres së kuotës së anëtarësimit dhe jo si shtese e kapitalit social.

Vlera e kuotës së anëtarësimit mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### Neni 11 - Detyrimet e ortakëve

Ortakët janë të detyruar të permbushin detyrimet e parashikuara në ligj e në statut dhe veçanërisht:

- a) të marrin pjesë në mbledhjen e asamblese së përgjithshme;
- b) të zbatojnë marrëveshjet e miratuara nga organet e shoqërisë;
- c) të marrin pjesë në veprimtari që perbejnë objektin e shoqërisë, sipas përcaktimeve të statutit, përveçse kur asambleja e përgjithshme, në rast të një shkakut të justifikueshem dhe sipas rrethanave, mund të përjashtojë nga ky detyrim ortakun
- d) të ruajnë sekretin për ato çështje dhe të dhëna të shoqërisë, përhapja e të cilave mund të demtojë interesat e ligjshëm të saj;
- e) të mos kryejnë veprimtari konkurruese me veprimtarinë e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur autorizohen formalisht nga asambleja e përgjithshme;
- f) të marrin pjesë në veprimtaritë e formimit dhe të kualifikimit;
- g) të kryejnë derdhjen e kuotës në kapitalin e shoqërisë në mënyrën dhe kohën e parashikuar nga ky statut dhe vendimi I administratorit;
- h) të permbushin detyrimet e tjera, që rrjedhin nga ligji dhe statuti.

### Neni 12 - Largimi i ortakut

1. Ortaku mund të përjashtohet nga shoqëria në rastet kur:

- a) vullnetarisht, me anë të dorëheqjes, shih nenin 13;
- b) i detyruar, me anë të përjashtimit në rastet e parashikuara në këtë ligj;
- c) kur transferon pjesën e zotëruar prej tij në kapitalin e shoqërisë tek një individ ose person juridik, i cili ka marrë miratimin e asamblese së përgjithshme;
- d) në rast shkrirjeje ose likuidimi, kur ortakët janë person juridik;
- e) në rast falimentimi;
- f) në rast vdekjeje;
- g) në cdo rast tjetër, të përcaktuar në ligj apo në statut;
- h) kur është në kundërshtim me dispozitat e kësaj statute ose kur kryen aktivitete në konkurrencë me interes të shoqërisë;
- i) nuk ka ose ka humbur çelësitë e duhura për anëtarësimin si ortak në këtë shoqëri;
- j) kur gjendet në një situatë papërcaktueshmërie, pa autorizimin paraprak të administratës

2. Administratori shprehet me vendim të motivuar për largimin e ortakut dhe vendimin e marrë ia përcjell për miratim asamblese së përgjithshme. Vendimi për përjashtim i komunikohet ortakut objekt i kësaj mase, me anë të letres së shkruar rekomandë dhe me marrje përgjigjeje.

3. Largimi i ortakut dhe cdo veprim, i cili ndryshon kapitalin e nënshkruar apo mënyrën e ndarjes së tij, duhet të shenohet në regjistrin e ortakëve, si dhe të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

4. Ortaku i cili do të ankohet kundër vendimit të marrë nga administrator duhet të promovojë procedurën arbitrale nëpërmjet prezantimit të kërkesës me shkrim brenda 60 ditëve nga marrja e njoftimit për masën e marrë ndaj tij.

### Neni 13 - Transferimi i kuotave

1. Ortaku ose kushdo, me të drejtë legjitime (i afërm e shkalles së parë) i cili dëshiron të heqë dorë totalisht ose pjesërisht nga kuota, për të marrë aprovimin e Këshillit Administrativ, duhet të paraqesë kërkesë me shkrim dhe arsyen e një kërkesë të tillë, e cila të përmbajë edhe emrin e ortakut, të cilit i transferohet kuota.



2. Nëse administratori nuk shprehet brenda 30 diteve pas marrjes së komunikimit, kërkesa konsiderohet e miratuar dhe ortakët mund të transferojë kuotën tek personi i specifikuar në kërkesën e mesipërme.

## KREU IV

### ORGANET E SHOQËRISË, ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME

#### Neni 14 - Organet e shoqërisë

Organet e shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administratës dhe Administratori i deleguar.

#### Neni 15 - Asambleja e përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme është organ vendimarrës dhe përbehet nga të gjithë ortakët e shoqërisë.

2. Asambleja e Përgjithshme, zgjedh kryetarin dhe sekretarin e shoqërisë.

Cdo anëtar i asamblese aktuale apo të ardhshme, e pranon si të mirëqene këto pike të statutit. Kryetari i Asamblese do të ketë të drejtën e vetos në çdo rast që shihet të nevojshme, mbi të gjitha vendimet e marra nga administratori/administratores, të cilët vazhdimisht veprojnë në emër dhe për llogarë të shoqërisë.

Si kryetari, ashtu edhe sekretari, mandatohen për një periudhë kohe trevjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Në mandatin e parë, **Kryetari i Asamblese së Përgjithshme do të jetë**

a) Në mandatin e parë, **Kryetari i Asamblese së Përgjithshme do të jetë Anila Murataj** lindur më 08.04.1979, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID nr 036013168, nr. Personal H95408053W, leshuar në datë: 05.05.2020.

b) **Sekretari** emërohet **Armanda Saku** lindur më 17.07.1983, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID nr 036535431, nr. Personal I35717065C, leshuar në datë: 19.10.2020.

3. Asambleja e përgjithshme, përveç sa mund të parashikohet në statut, ka këto kompetenca:

- a) vendos drejtimin e politikave ekonomike të shoqërisë;
- b) analizon raportin e gjendjes financiare, përfshirë llogaritë vjetore, shpërndarjen e fitimeve, ngarkimin e humbjeve, menaxhimin financiar dhe çeshtje të tjera të veprimtarisë ekonomike, që fëmohen të rëndësishme;
- c) emëron dhe shkarkon administratorin/et, ekspertin/et kontabel dhe likuiduesin/it, si dhe përcakton masën e shpërblimit të tyre;
- d) miraton zvogelimin apo zmadhimin e kapitalit;
- e) miraton ndryshime të statutit;
- f) vendos për shpërndarjen apo menyrën e përdorimit të fitimit të shoqërisë, sipas dispozitave të këtij ligji dhe statutit;
- g) vendos shkrirjen, ndarjen, transformimin apo shpërberjen e shoqërisë;
- h) vendos për ndryshimet e strukturs ekonomike, shoqërore, organizative apo funksionale të shoqërisë;
- i) vendos për pjesëmarrjen në formë të tjera të bashkëpunimit ekonomik edhe me anë të pjesëmarrjes në kapital, aderimin në organizata me karakter përfaqësues dhe shkeputjen prej tyre;



- j) miraton pasqyrat financiare, raportet per mbarevajtjen e veprimtarise se shoqerise, raportet e eksperteve kontabel dhe te likuiduesve;
- k) miraton pranimin e ortakeve te rinj dhe pjesemarrjen e tyre ne kapitalin e shoqerise, si dhe largimin apo perjashtimin e tyre;
- l) kryen detyra dhe ceshtje te tjera te percaktuara ne ligj apo ne statut.
- m) zbaton vendimet e marre nga Asemblea e Pergjithshme, si edhe kushtezimet per te gjithethe ortaket

#### Neni 16 - Thirrja e asamblese se pergjithshme

1. Asambleja e pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara me ligj, ne statut apo sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Asambleja e pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit dhe brenda gjashte muajve nga data e mbylljes se vitit financiar.
2. Asambleja e pergjithshme thirret nga administratoret ose nga ortaket e percaktuar sipas pikes 4 te neni 15 te ketij statuti.
3. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrim, jo me vone se 30 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Gjithsesi, ne raste urgjente ky afat mund te reduktohet ne 15 dite. Njoftimi duhet te permbaje:
  - a) emertimin e shoqerise, seline e regjistruar, vendin dhe oren e mbledhjes se asamblese;
  - b) rendin e dites se mbledhjes se asamblese se pergjithshme.

#### Neni 17 - E drejta e votes

Pervecse kur parashikohet ndryshe ne statut, cdo kuote jep te drejten e nje vote ne asamblene e pergjithshme.


#### Neni 18 - Perfaqesimi ne mbledhje

1. Nje ortak mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete, ne baze te nje prokure.
2. Administratoret nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme.
3. Prokura vlen vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.
4. Perfaqesuesi i autorizuar eshte i detyruar te deklarroje cdo fakt apo rrethane te tille qe, sipas gjykimit te ortakit te perfaqesuar, rrezikon te ndikojë ne vendimmarrjen e perfaqesuesit per interesa te tjere, te ndryshem nga ata te ortakut te perfaqesuar.
5. Nje ortak munde te perfaqesojë disa here, por jo me teper se 3 her.

#### Neni 19 - Kuorumi dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme

1. Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet duke bere njonftimin me leter rekomande me kthim pergjigje.
2. Asambleja e Pergjithshme, ka fuqi vendimmarrje, vetem kur anetaret e pranishem, perfaqesojne 60% te kapitalit social. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur ne piken 2 te ketij neni, asambleja mblidhet perseri, jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.
3. Votimi eshte i hapur, me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne statut.

#### Neni 20 - Procesverbali i mbledhjes se asamblese se pergjithshme





1. Te gjitha vendimet e asamblese se pergjithshme regjistrohen ne procesverbalin e mbledhjes, i cili nenshkruhet nga kryetari dhe nga sekretari.

2. Procesverbali dhe dokumentet e bashkelidhura duhet te ruhen per nje periudhe 5-vjecare dhe ortaket mund te kerkojne nje kopje te tyre.

## KREU V

### ADMINISTRATORET

#### EMERIMI I ADMINISTRATOREVE

##### Neni 21 - Emerimi i Administratoreve

Asambleja e pergjithshme emeron Administratorin e shoqerise.

Administratori i Shoqerise do te jete **Nertan Prifti** lindur me 14.09.1982, ne Librazhd dhe banues ne Tirane, identifikuar nepermjet leternjoftimit ID nr 036535163, nr. Personal I20914060L, leshuar ne date: 19.10.2020 i cili emerohet per nje periudhe trevjecare, me te drejte rizgjedhjeje.


##### Neni 22 - Kompetencat e Administratoreve

Administratoret kane keto detyra:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise se shoqerise, duke zbatuar politikat e percaktuara nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve, te regjistrave dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) pergatitin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ia paraqesin keto dokumente asamblese se pergjithshme per miratim;
- e) informojne ortaket dhe administratoret e tjere per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise se shoqerise;
- f) te kryejne regjistrimin prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, sic parashikohet me Ligj.
- g) raportojne tek Asambleja e Pergjithshme mbi realizimin e veprimtarise dhe arritjes se objektivave te shoqerise;

Nese statuti parashikon me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine ose me kompetenca te ndara sipas statutit. Ne cdo rast, Administratoret detyrohen:

- a) te kryejne detyrat e tyre te percaktuara ne ligj ose ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise, duke i kushtuar vemendje te vecante realizimit te suksesshem te objektit te shoqerise;
- b) te ushtrojne kompetencat qe u njihen ne ligj ose ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita dhe duke konsideruar si te rendesishem interesin e shoqerise dhe te ortakeve te saj;
- c) te parandalojne dhe te menjanojne rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- d) te mbaj te informuar me shkrim administratorin e deleguar per te gjitha vendimet dhe ose aktet eventuale, qe i shkaktojne deme ekonomike anetareve.
- e) te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojsh





Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ose administratorët ne fdo moment me shumice te thjeshte. Administratorit, te cilit i ka mbaruar mandati i plote i emerimit, vazhdon te kryeje detyrat e veta deri ne emerimin e administratorit te ri.

### Neni 23: Perfaqesimi

Keshilli mund te delegoje atributet e veta tek nje apo me shume administratore ose tek te tretet, duke percaktuar permbajtjen, kushtezimet dhe menytrat e ushtrimit te delegimit dhe gjithashtu duke mbajtur per gjithcka te informuar, administratorin e deleguar.

Delegimet e Administratoreve dhe cdo ndryshim i tyre, duhet te behen me shkrim dhe te regjistrohesh prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

### Neni 24 – Shkarkimi apo revokimi i Administratoreve

Administratori mund te revokohet ne rast se:

1. ne baze te Ligjit ne fuqi;
2. personi ndodhet ne gjendje te dyshimte;
3. personi vuan ose mund te vuaje nga crregullime mendore te dokumentuara nga raport mjeko-ligjor;
4. personi jep doreheqjen nga detyra;
5. ka munguar per me shume se gjashte muaj radhazi pa motiv justifikues

Revokimi do te kete efekt sipas vendimit te asamblese se pergjithshme, pas propozimit te keshillit te administrates.

### Neni 25 - Shperblimet e administratoreve

-Administratoret shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me parashikimet e ligjit.

- Shperblimi mund te jete ne para, pensione, sigurime dhe forma te tjera; i takon cdo komponenti te keshillit te administrates. Ne rast vdekjeje te administratorit, shperblimi i takon trashegimtarit te tij.

-Administratoreve kane te drejten e rimbursimit e te gjitha shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera per ushtrimin e aktivitetit te tyre per llogari te shoqerise.

### Neni 26- Mbledhjet e administratoreve


- Administratoret mblidhen ne rastet e percaktuara me ligj, ne statut apo sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise dhe minimumi cdo 60 dite.

-Mbledhjet e Administratoreve do te mbahen sipas nevojave te aktivitetit tregtar te shoqerise.

-Asambleja e Pergjithshme i cakton Administratorit te Deleguar ose Presidentit te shoqerise detyren e kryetarit te mbledhjes se administratoreve. Kryetari do te drejtoje cdo mbledhje te Administratoreve ne te cilat ai eshte i pranishem.

-Ceshtjet e rendit te dites vendosen me shumicen e votave te pjesemarreve. Gjithsesi, vetoja e Administratorit te Deleguar eshte vendimtare sipas statutit.

-Mbledhjet jane te vlefshme kur nderhyn shumica e Administratoreve ne fuqi dhe vendimet jane marre me shumice absolute nga Keshilltaret prezente. Ne rast te balotazhit, votimi i kryetarit te keshillit te administrates do te jete perfundimtar, ne menyre qe te shpallet nje vendim.





- Ne rast te perjashtimit te nje Administratori apo te deleguari te ketij te fundit, te gjitha vendimet e marra gjate mbledhjeve deri ne daten e perjashtimit do te konsiderohen te vlefshme.

-Me qellim vlefshmerine e mbledhjeve te Keshillit te Administrates, thirrja duhet te jete me shkrim 5 dite perpara, me saktessim te vendndodhjes, daten dhe rendin e dites; vendimet duhet te jene te shkruara dhe te nenshkruara nga te gjithte te pranishmit.

#### **Neni 27- Kufizimet ne votimet e administratoreve**

-Administratoret nuk duhet te lidhin marreveshje ose te votojne ne mbledhjen e Administratoreve, per ceshtje ne te cilin keta ortake kane , direkt ose indirekt, nje interes apo detyrim i cili eshte material, qe eshte apo mund te jete ne kundërshtim me interesat e shoqerise.

-Ne rast se mbledhjet kane per objekt perjashtimin e njerit prej komponenteve te keshillit te administrates, vendimi duhet merret pas dorheqjes se administratorit ne fjale.

-Ne rast se mbledhjet kane per objekt te drejten e votes se nje Administratori, vendimi i Kryetarit te administrates do jete perfundimtar dhe i formes se prere.

#### **Neni 28 - Procesverbalet e mbledhjeve te administratoreve**

Administratoret kujdesen qe ne libra te posacem te mbahen procesverbalet e:

1. te gjitha takimeve te kryera nga Administratorët;
2. te gjitha mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme.

### **KREU VI**

#### **REGJIMI EKONOMIK, KONTRIBUTET E ORTAKEVE**

#### **Neni 29 - Kontributet e Ortakeve**

Çdo anëtar derdh në momentin e pranimit për anëtarësim, përvet kuotes sociale, 1 (nje) kontribut anëtarësimi me vlerë 2.000 (dymije) lekë, që i përgjigjet vleres se kontributeve te ortakesimit. Kjo shume, nuk akumulohet si kuote sociale, por shkon ne llogarine e shoqerise, per mbulimin e kostove fillestare, e cila i rikthehet anetarit ne momentin e largimit, gjithmone pas vendimit te asamblese se pergjithshme dhe pas 12 muajve te autorizimit.


Vlera e kontributit të anëtarësimit mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 30 - Kapitali Kontributet ne leke dhe ne natyre**

1. Kapitali i shoqerise perbehet nga kuotat sociale, te cilat mund te jene ne para ose ne natyre. Kapitali ndahet ne kuota, te cilat zoterohen nga ortaket dhe perfaqesojne vleren e kontributit te tyre ne kapital.

2. Kontributet ne natyre duhet te shprehen ne vlere ekonomike, ne baze te nje raporti vleresimi, te bere nga nje ekspert. Nese nuk mund te arrihet ne mirekuptim per vleresimin, secili prej ortakeve mund t'i drejtohet gjykates perkatese per te ngarkuar nje ekspert vleresues, me nje vendim me efekt detyrues. Raporti i ekspertit per vleresimin e kontributeve i dorezohet Qendres Kombetare te Regjistrimit, se bashku me te dhenat e tjera, te kerkuara per regjistrim.

3. Kapitali minimal per krijimin e shoqerise se bashkepunimit bujqesor eshte 100 000 (njqind mije) leke.





**Neni 31 - Kontributet e detyrueshme**

1. Statuti mund te percaktoje kontributin e detyrueshem minimal i cili nuk duhet te jete me pak se vlera e percaktuar ne nenin 6.
2. Pjesa e nenshkruar si kontribut ne natyre duhet te shlyhet totalisht ne castin e nenshkrimimit te saj.

**Neni 32 – Rimbursimi i kuotave**

1. Kuotat e shoqerise mund te fitohen apo kalohen nepermjet:
  - a) Leshimit,
  - b) Trashegimise
  - c) Dhurimit,
  - d) Cdo menyre tjeter te parashkuar me ligj.

2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim., sipas rregullit te parashkuar ne nenin 13 te statutit.

**Neni 33 – Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar**

1. Asambleja e pergjithshme me shumice te kualifikuar mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ose me pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, gjithmon duke ruajtur raportin e perqindjeve fillestare te kapitalit, ndermjet anetareve shqiptar dhe anetareve italian.
2. Ne te njejten menyre Asambleja e Pergjithshme mund te vendose per zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise, i cili nuk munde te jete me i vogel se kapitali minimal i percaktuar nga Ligji.


**Neni 34 - Transferimi i pjeses se kapitalit**

Pjesa e kapitalit ne shoqeri fitohet ose transferohet duke pasur parasysh percaktimet e nenit 13 te ketij ligji dhe dispozitat e statutit, nepermjet:

- a) nenshkrimimit te kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) dhurimit;
- c) trashegimise, kur te interesuarit kerkojne te jene ortake. Transferimi i pjeses tek te interesuarit, te cilet gezojne cilesine e trashegimtarit dhe qe kerkojne te jene ortake, behet brenda gjashte muajve nga vdekja e ortakit. Ne rastet kur nuk permbushet kushti i siperpermendur, ata kane te drejte te kerkojne likuidimin e pjeses perkatese;
- d) cdo forme, te parashkuar me ligj.

**Neni 35 - Rimbursimi i kontributeve**

1. Ortaket, qe largohen nga shoqeria, rimbursohen per kontributet e derdhura ne kapital, sipas nenit 13 te ketij statutit.
2. Rimbursimi munde te behet duke respektuar minimumin ligjor, sipas nenit 6 te statutit dhe duhet te kryhet brenda dhe jo me vone se 5 vite, nga pranimi i Asamblese se Pergjithshme.
3. Statuti parashikon menyren dhe proceduren e rimbursimit te kontributeve.





**KREU VII****PERDORIMI I FITIMIT DHE KRIJIMI I REZERVAVE****Neni 36 - Fondi i rezerves se detyrueshme**

1. Shoqeria krijon fondin e rezerves se detyrueshme, i cili destinohet per konsolidimin dhe garancine e kapitalit te shoqerise se bashkepunimit bujqesor e te aftesise paguese te saj dhe eshte i pandashem ndermjet ortakeve dhe i patransferueshem, pervec rasteve te parashikuara ne nenin 56 te ketij ligji.

2. Fondi i rezerves se detyrueshme krijohet nga derdhja ne kete fond e nje shume jo me pak se 15% te te ardhurave neto, te realizuara ne cdo aktivitet dhe kjo rezerve nuk duhet te jet me e madhe se maksimumi ligjor.

**Neni 37 - Fondi i perballimit te riskut**

1. Shoqeria krijon fondin e perballimit te riskut, qe sherben per perballimin e rreziqeve apo demeve te cfaredolloj natyre, me te cilat mund te perballtet veprimtaria e shoqerise, perfshire ketu edhe fenomenet natyrore apo ato deme dhe risqe, te cilat jane te lidhura me vete llojin e veprimtarise ose te produktit.

2. Shoqeria depoziton ne fondin e perballimit te riskut te pandashem, nje perqindje e llogaritur mbi te ardhurat neto, te aktiviteve sociale te referuara, qe nuk munde te jet me pak se 10%.

**KREU VIII****DOKUMENTACIONI DHE KONTABILITETI****Neni 38- Kontabiliteti dhe bilanci vjetor**

Shoqeria mban kontabilitetin e veprimtarise se saj ekonomike, ne perputhje me ligjin dhe principet kontabile.

Administratoret pergatitin raportin e veprimtarise, inventaret dhe llogarite vjetore, ne perputhje me legjislacionin kontabel, te cilat ia paraqesin asamblese se pergjithshme per miratim.

**Neni 39 - Auditimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare te shoqerise pergatiten sipas legjislacionit ne fuqi dhe dispozitive per shoqerite me pergjegjesi te kufizuar, te percaktuara ne ligjin nr. 10 091, date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar".

Emerimi i Eksperteve Kontabel

Shoqeria cakton si ekspert kontabel te regjistruar Z. Ardit Hajdini me nris L41614007A

*[Handwritten signatures and initials]*



**KREU IX****SHKRIRJA DHE LIKUJDIMI****Neni 40- Shkrirja dhe likujdimi**

Shoqeria, pervec rasteve te parashikuara nga ligji, shkrihet ne rastet kur:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te asamblese se pergjithshme, sipas Statutit;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te neneit 43 te ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- e) me vendim te gjykates;

Shkrirja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese nga ana e Asamblese se Pergjithshme, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

**Neni 41 – Komunikimet**

- Cdo komunikim i kryer nga ortaket apo pale e trete duhet te jene me shkrim ose me poste elektronike ne adresen e parashikuar sipas nenit 4 te ketij Statuti.

- Ne te njejten menyre, komunikimet e Shoqerise me ortaket e saj duhet te jene ne formen e shkruar me poste rekomande ose elektronike sipas adreses se dhene nga ortaku.

Ky statut se bashku me ndryshimet dhe dokumente e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhena nga shoqeria do te publikohet nga Administratoret ne faqen e internetit te shoqerise, sipas parashikimeve te pikes 2 te nenit 4 te ketij Statuti ( nese zbatohet) .

**KREU X****DISPOZITA TE FUNDIT****Neni 42 - Mosmarrëveshjet**

Mosmarrëveshjet midis Shoqërisë dhe anëtarëve të saj zgjidhen sipas rregullave të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë e Bashkepunimit Bujqesor.


Ne rast se mosmarrëveshjet midis Shoqërisë dhe ortake te saj apo të tretëve nuk mund te zgjidhen miqesisht, ato do te zgjidhen në rrugë gjyqesore.

**Neni 43 - Depozitimi i Statutit**

Ky Statut është hartuar në 4 kopje, 1 prej të cilave depozitohet në Qendren Kombetare te Regjistrimit, Shqiperi për regjistrimin e Shoqërisë.

**Neni 44 - Miratimi i Statutit**

Ky Statut u miratua dhe u nënshkrua nga perfaqesuesit e anëtarëve themelues te Shoqerise:





1. ANILA MURATAJ *Anila Murataj*
2. ASIM SULA *Asim Sula*
3. NERTAN PRIFTI *Nertan Prifti*
4. ARBER XHAFERAJ *Arber Xhaferaj*
5. ARMANDA SAKU *Armanda Saku*
6. RENIS PRIFTI *Renis Prifti*
7. DOLOREZA PRIFTI *Doloreza Prifti*






**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER DRITA B. PEPI**



V2021052990099135841

DATE 31/08/2021  
NR REP 1916



**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 31.08.2021 , para meje Notere DRITA B. PEPI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.7, GJERGJ FISHTA, KULLAT"GORA", NR. 5/3, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES/IT:**

Arbër Xhaferaj, atësia Pëllumb, amësia Tatjana, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Musa Maçi; Nd. 37; H. 1; Ap. 6; Njësia Administrative Nr. 8; Njësia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 27/10/1985, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036201221 dhe nr. personal I51027051J , .

**NËNSHKRUES/IT:**

Anila Murataj, atësia Besim, amësia Marie, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Kadri Aziz Hoxha; Nd. 20; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 08/04/1979, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036013168 dhe nr. personal H95408053W , .

**NËNSHKRUES/IT:**

Nertan Prifti, atësia Vangjel, amësia Eliverta, shtetas Shqiptar, lindur në Librazhd dhe banues në Tiranë, me adresë 'muhamet Gjollësja'; Nd. 67/6; H. 1; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 7; Njesia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 14/09/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036535163 dhe nr. personal I20914060L , .

**NËNSHKRUES/IT:**

Armanda Saku, atësia Luan, amësia Vojsava, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë 'muhamet Gjollësja'; Nd. 67/6; H. 1; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 7; Njesia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 17/07/1983, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036535431 dhe nr. personal I35717065C , .

**NËNSHKRUES/IT:**

Asim Sula, atësia Dane, amësia Mustikale, shtetas Shqiptar, lindur në Luzaj, Berat dhe banues në ELBASAN, me adresë Mehmet Kothere 00910346; Nd. 2; H. 7; Ap. 8; Elbasan; Elbasan; 3001; Elbasan, lindur më 17/04/1968, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të





V2021052990099135841

cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035835118 dhe nr. personal G80417196V

**NËNSHKRUES/IT:**

Renis Prifti, atësia Piro, amësia Hermelinda, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë 'muhamet Gjollësja'; Nd. 60; H. 02; Ap. 26; Njësia Administrative Nr. 7; Njesia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 13/05/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033596605 dhe nr. personal H90513055K , .

**NËNSHKRUES/IT:**

Doloreza Prifti, atësia Dhosi, amësia Donika, shtetas Shqiptar, lindur në Leskovik, Kolonjë dhe banues në Tiranë, me adresë 'muhamet Gjollësja'; Nd. 60; H. 02; Ap. 26; Njësia Administrative Nr. 7; Njesia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 18/01/1981, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034235852 dhe nr. personal I15118053K , .

Shtetasit e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statut ", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER  
DRITA B. PEPI

